



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 166 Prot.

Tiranë, më 20.06 2018

UDHËZIM

Nr. 22, datë 20.06 2018

**PËR
NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 21. 5. 2018 “PËR PROCEDURAT E
APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI
DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2018–2019”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.04.2018 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019”,

UDHËZOJ:

1. Pika 4 e germës “B” e kreut të II të Udhëzimit të MASR nr. 18, datë 21. 5. 2018, ndryshon si vijon:

4. “Në datën 10 gusht 2018, IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjeidset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse listat e aplikantëve. Në periudhën 11-27 gusht 2018 do të zhvillohen konkurset e pranimit.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

